



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 77, Datë 15.03.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS TË SHOQËRISË  
“FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” (FTL) SH.A., NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1039/1 prot., datë 16.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 422, seria T18, të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL sh.a.), në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 999 prot., datë 03.03.2023, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për

shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë kryesisht dokumentacionin si vijon:

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “FTL” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:  
**Neni 16, gërmat “a” dhe “b”.**
- Nga aplikimi konstatohet se shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:  
**Neni 16 Rinovimi i licencës**
  - **gërma “c” Shoqëria duhet depozitohet në ERE informacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata përkatëse) për të gjitha vitet gjatë të cilave ka qenë e pajisur me licencën e tregimit të energjisë elektrike.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës të shoqërisë “FTL” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**